



**KOSOVO PROPERTY AGENCY**  
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Perandori Justinian 5 - Prishtinë/Pristina  
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919  
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NË MBROJTJE TË PRONËS PRIVATE – PROTECTING PRIVATE PROPERTY – ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), i cili përcakton të drejtën(at) pronësore për sa i përket kërkesës(ave) të paraqitur(a) në Agjencinë Kosovare të Pronës.

**Vërejtje:** Ju do të pranoni një vendim zyrtar të vërtetuar në gjuhën angleze si dhe versionet e vërtetuara dhe të përkthyer të këtij vendimi në gjuhën shqipe dhe serbe. Versioni në gjuhën angleze është vendim zyrtar, prandaj në rrethanat kur ka ndonjë mospërputhje me versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë do të mbizotërojë përmbajtja e versionit në gjuhën angleze.

#### VENDIM I VËRTETUAR

SIPAS NENIT 8.8 TË ANEKSIT III TË URDHËRESËS  
ADMINISTRATIVE TË UNMIK-ut 2007/5 TË PËRSHTATUR NË  
LIGJIN NR. 03/L-079 TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS

**PARAQITËSI I KËRKESËS:** #emri(at) i(e) paraqitësit(ve) të kërkesës(ave)#

**KËRKESA(T) NR.:** #Nr(at) e AKP-së#

**PALA PËRGJEGJËSE:** #emri i palës(ve) përgjegjëse

#### IDENTIFIKIMI I PRONËS SË KËRKUAR

Prona lëndë në këtë kërkesë gjendet në komunën e #komuna#, në #vendi#, numri i fletës poseduese #numri i fletës poseduese të paraqitësit(ve) të kërkesës#, zona kadastrale #emri i zonës# numri i parcelës #parcela nr.# me sipërfaqe #sipërfaqja#

- Në Vendimin Grupor KKPK/D/#nr#/#viti# të datës #data# Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës ka vendosur që:

(a) *Paraqitësi(t) i(e) kërkesës(ave) sipas detajeve më lart ka/kanë dëshmuar se #emri i Bartësit të së Drejtës Pronësore# është pronar mbi #pjesa(ët) ideale e(të) pronës# të pronës së kërkuar;*

dhe urdhëron që:

(a) *#emri i Paraqitësit(ve) të kërkesës(ave)# apo #emri i Bartësit të së Drejtës Pronësore# ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë;*

(b) *Pala(ët) përgjegjëse, nëse ka ndonjë, dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë pronën brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe*

(c) *Nëse Pala përgjegjëse ose çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë këtë urdhër për të liruar pronën e kërkuar gjatë kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona.*

Do të keni një vendim të individualizuar zyrtar dhe të vërtetuar (vendim i vërtetuar) dhe një vendim grupor. Vendimi i vërtetuar ka rëndësi të madhe për ju dhe përshkruan kërkesën(at) tënde (tuaja) individuale, duke ju njoftuar nëse KKPK-ja ka aprovuar apo refuzuar kërkesën(at) tënde(tuaja) dhe çfarë ka urdhëruar. Vendimi grupor është vendim i nënshkruar nga Kryetari i KKPK-së, i cili përfshinë numër të madh të kërkesave të vendosura gjatë të njëjtës seancë, duke përfshirë po ashtu edhe kërkesën(at) tuaj(a) individuale.

**Identifikimi i Pronës** -Kjo është adresa e pronës, e cila është dhënë me rastin e paraqitjes së kërkesës suaj në AKP. Nëse konstatooni se adresa është e ndryshme nga ajo në vendim, ju lutem kontaktoni menjëherë ndonjërin nga zyrtarët e AKP-së. Informatat në lidhje me lokacionin dhe detajet kontaktuese të të gjitha zyrtarëve të AKP-së do t'i gjeni në fund të këtij dokumenti.

**Pika numër 1** e Vendimit të Vërtetuar ju ofron rezultatin kryesor të vendimit të KKPK-së në lidhje me kërkesën tuaj dhe është e ndarë në disa nën pika p.sh. a-d. Prandaj, kjo pikë është pjesa më e rëndësishme e vendimit tuaj.

Rreshti i parë i vendimit tregon numrin e regjistrimit të vendimit grupor të KKPK-së, si dhe datën në të cilën është marrë ky vendim.

**Numri 1 (a)** konfirmon nëse pronësia apo e drejta e shfrytëzimit është aprovuar apo refuzuar dhe kujt. **Numri 1, pikat (b), (c) dhe (d)** përshkruajnë urdhërin i cili pason pas konfirmimit të pronësisë apo të së drejtës së shfrytëzimit, më saktë aprovimin e riposedimit paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore dhe urdhërin për dëbim (nëse është i aplikueshëm) të çdo personi tjetër i cili e ka uzurpuar pronën.

2. Përveç kësaj Komisioni ka vendosur që:
  - a. Në rastet kur ka më shumë se një pronar në pronën e kërkuar, vendimi i mësipërm dhe urdhri nuk ndikon në të drejtat e ndonjërit nga bashkë-pronarët përkatës.
  - b. **\*nëse ka kërkesë për kompensim\*:** Kërkesa për kompensim të dëmit fizik, apo humbjes së shfrytëzimit, të pronës së kërkuar është refuzuar meqë Komisioni nuk ka jurisdiksion mbi kërkesat e tilla.
3. Kërkesa është zgjidhur sipas Vendimit Grupor të sipërpërmendur, i cili është bashkëngjitur. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 i lejon Kryetarit të Komisionit të nënshkruajë vendim grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë.
4. Përveç paragrafëve përkatës në Vendimin Grupor, paragrafi(ët) **\*fut paragrafët e përmendur në shtyllën D të listës\* #X dhe X#** aplikohet/aplikohen në mënyrë specifike për kërkesën.
5. Ky vendim individual është vërtetuar në emër të KPCC-së.

.....  
Data

Udhëheqësi i Zyres së  
Komisionit Për Kërkesa Pronësore i Kosovës

**Numri 2 pika a)** do të sqarohë nëse dhe si ndikon vendimi në të drejtat e ndonjërit nga bashkë-pronarët.

**Numri 2 pika b)** - aplikohet vetëm në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për kompensim në lidhje me dëmin material, apo humbje të posedimit të pronës së kërkuar. Meqë, KKPK-ja nuk ka mandat të jap urdhër për kompensim, atëherë ky paragraf ju informon se ky aspekt i kërkesës tuaj është refuzuar.

**Pikat Numër 3 dhe 4** tregojnë se vendimi juaj është vendosur si pjesë e Vendimit Grupor (siç është sqaruar paraprakisht), dhe sqarojnë se përveç paragrafëve të përgjithshëm të aplikueshëm për të gjitha kërkesat e përmendura në Vendimin Grupor (vendimi), ka edhe paragraf të caktuar, i cili aplikohet vetëm për kërkesën e caktuar dhe cek arsyetimin për vendimin.

**Ankesat për Gjykatën Supreme të Kosovës** - Nëse nuk pajtoheni me vendimin e KKPK-së apo pjesëve të tij, keni të drejtë të ankoheni në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së. Udhëzimet dhe informatat e detajuara mbi procesin e ankesës janë shtypur në fletë të veçantë dhe i është bashkëngjitur vendimit.

Paraqitësi i suksesshëm i kërkesës mund të kërkojë (1) **riposedimin e pronës së kërkuar**, (2) **të kërkojë që rasti të mbyllet** ose (3) **të vë pronën nën administrim të AKP-së**. Formularët për të kërkuar mjetet juridike do t'ju dorëzohen të gjithë paraqitësve të suksesshëm të kërkesave.

Mjetet juridike për zbatim mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, dëbimin, vënien e pronës nën administrim, marrëveshjen mbi qiranë, konfiskimin dhe shkatërrimin e objekteve të paligjshme dhe ankandin. Dëbimi do të bëhet pas kërkesës për riposedim të paraqitësit të suksesshëm të kërkesës, në rastet kur është konstatuar që në pronë ka uzurpues të paligjshëm dhe në mënyrë të dukshme vërehen aktivitetet të paligjshme, dhe uzurpimi i paligjshëm apo aktiviteti i paligjshëm nuk ndërpritet as pas njoftimit të të gjitha palëve mbi kërkesën për riposedim. Ju do të njoftoheni me kohë çdo ndonjë dëbim apo mjet tjetër juridik të ndërmarrë.

Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në lidhje me vendimin, ju mund t'i sqaroni ato duke kontaktuar ndonjërin nga anëtarët e personelit tonë në ndonjërin nga zyrat tona regjionale. Si paraqitës i kërkesës, palë përgjegjëse apo palë tjetër e interesuar, ju mund të paraqiteni personalisht në njërin nga zyrat tona. Nëse nuk mund të paraqiteni personalisht, mund të autorizoni një person tjetër të paraqitet në emër tuajin, ju lutem dërgoni autorizimin me shkrim personalisht apo me postë në ndonjërin nga zyrat e AKP-së, së bashku me kopjen e Letërnjoftimit të saj/tij. Këto kontakte, çfarëdo forme që mund të kenë, nuk përbëjnë ankesë nëse u përmbahen udhëzimeve të detajuara mbi procesin e ankesës të prezantuar në fletën e veçantë.

**Vërejtje** – Të gjithë personat të cilët janë të regjistruar në AKP si Paraqitës i kërkesës, Palë përgjegjëse apo palë tjetër e interesuar në kërkesë mund të gjejnë informata mbi kërkesën, pavarësisht nëse është vendosur apo, gjithashtu edhe informatave tjera të dobishme, duke vizituar ueb faqen tonë: [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org). Nëse mendoni se fotografitë tregojnë pronë tjetër nga ajo për të cilën ju keni paraqitur kërkesë, ju lutem kontaktoni menjëherë njërin nga zyrat e AKP-së.

**KPA ZYRET/KPA OFFICES/KANCELARIJE KPA. Selia/Headquarters/Sedište;** Rr.“Nazim Gafurri 31”Prishtinë/Priština, tel.038/249-918, fax.038/249-919. **Prishtinë/Priština;** Rr.“Rexhep Luci 2”/Redžep Ljuci 2, tel.038/225-473, fax.038/244-854. Graçanicë/Gračanica, Vidovdanska bb. **Prizren,** Rr.“Wiliam Walker”pn Prizren (ne zryen e EULEX-it)/Wiliam Walker bb Prizren (EULEX baza), tel.038/760-610; 038/760-611. **Gjilan/Gnjilane;** Rr.“Lidhje e Prizrenit 114” tel.0280/320-289, fax.0280/324-067. **Mitrovicë/Mitrovica;** Rr.“Mbretëresha Teuta”(përballë Jugobankës)/Mbretëresha Teute bb.(preko puta Jugobanke), tel.028/530-136, fax.028/530-139, Pjesa Veriore e Mitrovicës/Severni deo Mitrovice; Rr.Ndërtesa e AKM-së, Dhoma nr.18, Kompleksi i Stacionit Verior të UNMIK-ut/Filipa Višnjica bb. Zgrada TREPCE drugi sprat kancelarija br.18 tel:063/197-6470. **Pejë/Peć;** Rr.“Mbretëresha Teuta 85”/Mbretëresha Teuta 85, tel.039/431-668, fax.039/432-970. **Beograd;** “Kosovës 49”/Kosovska 49,tel.011/334-5513, fax.011/334-5314, 011/334-4452. **Podgoricë/Podgorica;** “Crnogorskih Srdara bb” tel.+382 20 624-216; 623-744. **Shkup/Skopje:** “Vinichka No.10” (ndërtesa e CDRIM)/Vinička ulica No.10 (CDRIM-zgrada), prvi sprat, tel: +389 71 886 564. **Kragujevc/Kragujevac,** “Lole Ribara” Street tel: 034 330-234; 330-784 3rd Floor **Nish/Nis** Dusanov Bazar, Kupola 2nd Floor, Office No. 210 tel: 018/203-777